


INDEKSI I TRANSPARENCËS SË 61 NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

DHJETOR 2021



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Raport Monitorimi

Transparenca Proaktive e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Monitorimi u krye nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Raporti u hartua nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përmbajtja

Hyrje	3
Metodologjia	5
Indeksi i Transparencës Proaktive për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.....	7
Gjetjet përfundimtare “Indeksit i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”	9

Hyrje

E drejta për informim është e drejta e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimi i autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë pa kërkuar motivet. E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila pas miratimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka sjell një garanci më të madhe ligjore për aksesin e qytetarëve në informacion dhe kushtet e duhura të transparencës proaktive për të ushtruar të drejtat e tyre.

Një nga risitë e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është dhe përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Njëpërmjet Programit të Transparencës, i cili publikohet në faqen zyrtare, bashkitë vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, përcaktojnë mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur këtë informacion.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018, ka miratuar “Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për t’u implementuar nga 61 bashkitë e vendit që prej 1 janarit 2019. Programi model është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore, në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e “Kartës evropiane të autonomisë vendore”.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

[Vendosim brenda e bashkitë]

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtu informacioni	Afati kohor për publikimin	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<p>Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet. Bashkia ben publike:</p> <p>1. Ndarjen administrativo-territoriale</p> <ul style="list-style-type: none"> Njësit administrative dhe rën-ndarjet e tyre <p>2. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e bashkisë.</p> <p>3. Funksionet: Përfaqshat brejen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtimore Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kulturave publike, natyrës dhe biodiversitetit Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor Funksioneve në fushën e sigurisë publike Funksionet dhe kompetencat e deleguara 	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 115/2014</p> <p>Neni 23-30 i ligjit nr. 139/2015</p>	<p>a) Në faqen e tyre të internetit - menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (shtohet adresa e vendeve)</p>	Mendherë	Sipas aktëve ligjore dhe rëndësorisë së faqes	Kryetari i Bashkisë
2.	<p>Organi përfaqësues i Bashkisë-Këshilli bashkiak (përbërja, struktura, detyrat dhe kompetencat). Përfaqshat brejen publike të:</p> <p>1. Këshilli bashkiak (Kb):</p> <p>1.1 Përbërja dhe struktura</p> <ul style="list-style-type: none"> Anëtarët Kryetari i këshillit Sekretari i këshillit Komitetet 	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 139/2015</p>	<p>a) Në faqen e tyre të internetit - menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (shtohet adresa e vendeve)</p>	<p>Mendherë</p> <p>Vendimet e Kb - brenda 10 ditëve nga data miratimit të tyre. Njoftimi për mbledhjen e</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Thirrja e mbledhjes së Kryetarit i Kb</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p>

Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës në nivel vendor është edhe monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Monitorimi lejon të vlerësohet niveli i transparencës në nivel bashkie. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehet mosrespektimi i tyre, bën vlerësimin e kundravajtjeve dhe vendos masën administrative përkatëse.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë gjithë vitit 2021, monitoroi faqet zyrtare të 61 Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Nga monitorimet e kryera, Komisioneri doli me 36 rekomandime për ato autoritete publike të cilat pas monitorimit online për zbatimin e Urdhrit nr. 211 datë 10.09.2018 “Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, kanë rezultuar se kanë pasur mangësi në publikimin e informacionit të detyrueshëm në rubrikat e këtij programi.

Për sa i përket problematikave që u konstatuan përmes rekomandimeve, kryesisht kishin të bënin me rishikimin/përditësimin/zbatimin e programit të transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe pasqyrimin në këtë të fundit të të gjithë kategorive të informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik në përputhje me parashikimet në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Autoriteteve publike iu la një afat kohor 90 (nëntëdhjetë) ditë për përmbushjen e detyrimeve, si dhe plotësimin dhe ndreqjen e problematikave të adresuara.

Në përfundim të këtij afati, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 20 hetime administrative ndaj Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me object, monitorimin e vënies në zbatim të programit të transparencës. Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit konstatoi përmbushjen e detyrimit të publikimit të programeve të transparencës nga ana e 19 Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, ndërkohë vetëm një (1) Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, në përfundim të procesit të plotë administrative, nuk e plotësoi detyrimin dhe për këtë arsye Zyra e Komisionerit vendosi sanksionimin e personit përgjegjës me masë administrative gjorbë.

Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës kërkon një impenjim të institucioneve publike për ta përditësuar, plotësuar dhe pasuruar me informacion në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, monitorimi i transparencës të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore kryhet në bazë vjetore, duke lehtësuar kështu kryerjen e analizave krahasimore në të ardhmen.

Zyra e Komisionerit përtej angazhimit të saj institucional në monitorimin e zbatimit të detyrimit ligjor për miratimin, publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, sjell për vitin e dytë radhazi “Indeksin e transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Ky indeks ndjek një metodologji të caktuar e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelin e transparencës proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, duke krahasuar trendin e transparencës së tyre ndër vite.

Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të rritur nivelin e transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por

ato shërbejnë edhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 5 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 5 (pesë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki.

Instrumenti kryesor për matjen e transparencës proaktive është publikimi i Programit Model të Transparencës në faqen zyrtare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sistemi i matjes i përdorur në këtë metodologji është i thjeshtë dhe lejon një vlerësim të shpejtë të treguesve bazuar në gjendjen reale të tyre në momentin e kërkimit në faqen zyrtare të internetit.

Ky sistem krijon mundësinë e përdorimit të menjëhershëm për shkak të lehtësisë së përdorimit dhe shpejtësisë, në arritjen e përfundimeve në lidhje me përcaktimin e nivelit të transparencës.

Sistemi i matjes së transparencës përfshin 5 tregues të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës në secilës bashki. Një sistem i tillë i shërben Zyrës së Komisionerit si një bazë për të monitoruar nivelin funksional të transparencës, me qëllim evidentimin e progresit, pikat e dobëta dhe të forta.

Treguesi i parë:

Publikimi i Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike sipas urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore”,

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i dytë:

Publikimi i Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2021, sipas urdhrin nr. 188, dt. 18/12/2020 “Për miratimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i tretë:

Të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i katërt:

Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin publik”.

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Treguesi i pestë:


Publikimi i të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021.

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar
0,5-informacioni është publikuar pjesërisht
1-informacioni është i publikuar

Ky sistem matje i transparencës proaktive i referohet dhe është i ngjashëm me sistemin e matjes së transparencës së Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2020, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në linkun e mëposhtëm:

https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/12/Indeksi_-i-transparences_-bashkite_monitorim_bashkite_nentor_2020_ok-1.pdf

Një tjetër risi e indeksit të transparencës së Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore ka të bëjë me sistemin e matjes së treguesve. Për të sjellë një analizë më cilësore të të dhënave, matja e treguesve është kryer me 3 nivele: 0 pikë në rast se informacioni nuk është publikuar; 0,5 pikë kur informacioni është publikuar pjesërisht dhe 1 pikë kur informacioni është i publikuar plotësisht.



Ky sistem matje i transparencës proaktive ngjan me një sistem semafor.

Autoritetet Publike që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0-0.5 pikë, kanë një transparencë proaktive pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 1-2 pikë, kanë një transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 2.5-4 pikë kanë një transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Autoritetet Publike të cilat i kanë të gjithë treguesit pozitiv dhe kanë grumbulluar 4.5-5 pikë kanë një transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.

Indeksi i Transparencës Proaktive për të gjitha Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoroi në muajin nëntor - dhjetor faqet zyrtare të 61 Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar 5 treguesit kryesorë të monitorimit të cilat janë: publikimi i programit të transparencës sipas urdhrit nr.211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”; publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve i rishikuar për vitin 2021, publikimi i të dhënave të koordinatori për të drejtën e informimit, publikimi i të dhënave të koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe informacion mbi buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2021.

Nr.	Autoritet Publik	Programi i Transparencës	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve	Koordinatori Për të drejtën e informimit	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	Buxheti	Totali
1	Bashkia Shkodër	1	1	1	1	1	5.0
2	Bashkia Patos	1	1	1	1	1	5.0
3	Bashkia Korçë	1	0.5	1	1	1	4.5
4	Bashkia Dimal	1	0.5	1	1	1	4.5
5	Bashkia Gramsh	1	1	1	0.5	1	4.5
6	Bashkia Klos	1	1	1	0.5	1	4.5
7	Bashkia Malësi e Madhe	0.5	1	1	1	1	4.5
8	Bashkia Shijak	1	0.5	1	1	1	4.5
9	Bashkia Tiranë	1	1	1	1	0	4.0
10	Bashkia Vlorë	1	1	1	1	0	4.0
11	Bashkia Bulqizë	1	1	1	0	1	4.0
12	Bashkia Finiq	1	0.5	1	0.5	1	4.0
13	Bashkia Kolonjë	1	0.5	1	0.5	1	4.0
14	Bashkia Lezhë	1	0.5	1	0.5	1	4.0
15	Bashkia Lushnje	1	1	1	1	0	4.0

16	Bashkia Maliq	1	0.5	1	1	0.5	4.0
17	Bashkia Prrenjas	1	0.5	1	0.5	1	4.0
18	Bashkia Pustec	1	1	1	0	1	4.0
19	Bashkia Tropojë	1	0,5	1	1	0	3.5
20	Bashkia Berat	1	0.5	1	0.5	1	3.5
21	Bashkia Devoll	1	0.5	1	0	1	3.5
22	Bashkia Dibër	1	0.5	1	0	1	3.5
23	Bashkia Dropull	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
24	Bashkia Elbasan	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
25	Bashkia Has	1	0.5	1	0	1	3.5
26	Bashkia Kamëz	1	0.5	1	0	1	3.5
27	Bashkia Kukës	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
28	Bashkia Libohovë	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
29	Bashkia Mallakastër	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
30	Bashkia Memaliaj	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
31	Bashkia Pogradec	1	0.5	1	0.5	0.5	3.5
32	Bashkia Skrapar	1	0	1	0.5	1	3.5
33	Bashkia Vau Dejes	1	1	1	0.5	0	3.5
34	Bashkia Belsh	1	0.5	1	0	0.5	3.0
35	Bashkia Fier	1	0.5	1	0	0.5	3.0
36	Bashkia Himarë	0.5	1	1	0	0.5	3.0
37	Bashkia Konispol	1	0	1	0	1	3.0
38	Bashkia Krujë	1	0.5	1	0	0.5	3.0
39	Bashkia Kuçovë	1	0.5	1	0	0.5	3.0
40	Bashkia Mat	0.5	0.5	1	0.5	0.5	3.0
41	Bashkia Përmet	0.5	0.5	1	0.5	0.5	3.0
42	Bashkia Pukë	1	0	1	0	1	3.0
43	Bashkia Roskovec	1	0.5	1	0.5	0	3.0
44	Bashkia Vorë	1	0,5	1	0	0	2.5
45	Bashkia Cërrik	1	0.5	0.5	0	0.5	2.5
46	Bashkia Divjakë	1	0.5	1	0	0	2.5
47	Bashkia Durrës	1	0.5	1	0	0	2.5

48	Bashkia Gjirokastrër	1	0.5	1	0	0	2.5
49	Bashkia Këlcyrë	1	0.5	1	0	0	2.5
50	Bashkia Librazhd	0.5	0.5	0.5	0	1	2.5
51	Bashkia Poliçan	1	0	1	0.5	0	2.5
52	Bashkia Sarandë	1	0.5	1	0	0	2.5
53	Bashkia Delvinë	1	0	1	0	0	2.0
54	Bashkia Mirditë	0.5	0	0.5	0.5	0.5	2.0
55	Bashkia Selenicë	1	0	1	0	0	2.0
56	Bashkia Fushë-Arrëz	1	0	0	0	0	1.0
57	Bashkia Peqin	0.5	0	0	0	0.5	1.0
58	Bashkia Tepelenë	1	0	0	0	0	1.0
59	Bashkia Kavajë	Nuk ka faqe aktive	0	0	0	0	0.0
60	Bashkia Kurbin	Nuk ka faqe aktive	0	0	0	0	0.0
61	Bashkia Rrogozhinë	Nuk ka faqe aktive	0	0	0	0	0.0

Gjetjet përfundimtare “Indeksit i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”

Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore janë renditur në Indeksin e Transparencës Proaktive sipas rezultateve të monitorimit bazuar në metodologjinë e semaforit, duke vendosur në fillim të listës Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore të cilat kanë grumbulluar 5 pikë dhe në rend zbritës deri në 0.

Në përfundim të monitorimit të kryer rezultojnë se, 8 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të lartë” (semafor i gjelbër), 44 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive mesatare (semafor i bardhë), 6 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të ulët (semafor i verdhë) dhe 3 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë periudhës së monitorimit nuk kanë pasur faqe zyrtare aktive dhe për këtë arsye janë vlerësuar me 0 pikë duke rezultuar të kenë një “Transparencë proaktive të pamjaftueshme” (semafor i kuq);

Në konkluzion të monitorimit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore gjatë vitit vitit 2021 vërejmë se, në krahasim me vitin 2020, kemi një rritje të transparencës

proaktive, veçanërisht në 3 indikatorët e parë të metodologjisë dhe konkretisht, “Publikimit të programit model të transparencës”, “Përditësimin të regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve” dhe “Publikimin e të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit”.

Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se 57 njësi të vetëqeverisjes vendore, kanë publikuar “Programin e Transparencës”, c’ka përbën 93% të totalit të bashkive. Në të njëjtin trend është edhe indikatorin e “Publikimit të të Dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”, ku 55 njësi të vetëqeverisjes vendore (90%) të monitoruara, e kanë publikuar informacionin përkatës plotësisht ose pjesërisht.

Në lidhje me “Publikimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve”, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2021. Numri total i njësisve të vetëqeverisjes vendore, të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave është 48, përkundrejt 61 bashkive të monitoruara, çka përbën 78 % të autoriteteve publike që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve.


Përsa i takon detyrimin lidhur me publikimin e informacionit proaktiv i cili ka të bëjë me “Publikimin e të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021”, është konstatuar se kanë publikuar pjesërisht ose plotësisht buxhetin e vitit 2021, vetëm 41 autoritete publike, përkundrejt 61 të monitoruara (67%).

Ndërkohë gjatë vitit 2021 janë konstatuar mangësi më të theksuara mbi detyrimin “Për caktimin dhe publikimin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili duhet të jetë i publikuar edhe në programin e transparencës. Nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore rezultojnë se 32 (52%) prej tyre kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për njoftimin publik, ndërsa bashkitë e tjera nuk e kanë publikuar.

Në krahasim me monitorimin e kryer në vitin 2020, rezultojnë se gjatë vitit 2021, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një performancë më të mirë në publikimin e informacionit proaktiv në faqet e tyre zyrtare të internetit nëpërmjet të cilit është kryer dhe ky monitorim.

Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, krahasimi i vlerave në % i monitorimit të publikimit të programit të transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, publikimi i të dhënave të koordinatorëve për të drejtën e informimit, përditësimi i regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, gjatë vitit 2021, është në nivele më të larta se në vitin 2020.

Tab. 1 Rezultat e monitorimit të zbatimit të Programit të Transparencës në vitin 2021 dhe vitin 2020 për njësitë e vetëqeverisjes vendore.



Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por të shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.